



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik nr.06/L-011, në kërkesë të Agjencisë kundër Korrupsionit nr. prot. 01-1224/19, datë 13.06.2019, merr;

### VENDIM PËR CAKTIMIN E ZYRTARIT PËRGJEGJËS PËR TRAJTIMIN DHE ZGJIDHJEN E SITUATAVE TË KONFLIKTIT TË INTERSIT

#### Neni 1

Zyrtar përgjegjës për trajtimin dhe zgjidhjen e situatave të konfliktit të interesit n'kuadër të Komunës e Podujevës, caktohet:

**z. Sabedin Namani**, udhëheqës i sektorit ligjor  
E-mail; [sabedin.namani@rks-gov.net](mailto:sabedin.namani@rks-gov.net)  
Voip: 038 200 41-023  
Tel mob.: 044/422-062

#### Neni 2

Zyrtari i caktuar detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në pajtim me Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik dhe akteve tjera përkatëse ligjore dhe nënligjore, si dhe bashkëpunon dhe koordinon me Agjencinë kundër Korrupsionit.

#### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

*U dërgohet:  
Të caktuarit  
Agjencisë Kundër Korrupsionit  
Arkivës*

**Nr.prot. 02-020/05-0053195/19**  
**Podujevë, 02 korrik 2019**



  
**Kryetari i Komunës**  
**Agim Velu**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja c të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040 dhe nenet 16 dhe 61.3 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, merr:

### VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR MBIKQYRJEN DHE PËRCJELLJEN E FUSHATËS PËR KORRJE-SHIRJE NË TERRITORIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS PËR VITIN 2019

#### Neni 1

Ngritet Komisioni komunal për mbikëqyrjen dhe përcjelljen e fushatës për korrje-shirje në territorin e Komunës së Podujevës për vitin 2019, në përbërje:

- |                   |          |
|-------------------|----------|
| 1. Behë Govori    | kryesues |
| 2. Eset Abdullahu | anëtar   |
| 3. Afrim Mulliqi  | anëtar   |

#### Neni 2

Komisioni bën mbikëqyrjen dhe kujdeset për mbarëvajtjen e fushatës së korrje-shirjeve në territorin e Komunës së Podujevës.

#### Neni 3

Për punën e kryer Komisioni në formë të shkruar informon Kryetarin e Komunës, përmes Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Nr.02-020/04-0053139/19  
Podujevë, 02 korrik 2019



  
Kryetar i Komunës  
Agim Veliu



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja l) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 (i) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr.03/L-087, nenin 23 (Lista 2 nr.20) të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, neneve 16, 19 paragrafi 1.12 dhe 61 paragrafi 1.3, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, dhe sipas nenit 1 paragrafi 2 të Vendimit nr.01-020/04-0037944/19 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim SH.A. Podujevës, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës, më 08 maj 2019, merr,

### **VENDIM PËR EMËRIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE PËR BANIM SH.A. PODUJEVË**

#### **Neni 1**

Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike për Banim sh.a. – Podujevë, emërohet,

***z. Durim Salihu, Drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit***

#### **Neni 2**

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit, përkatësisht anëtarit të emëruar, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

#### **Neni 3**

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës, nr. 01-020/04-0037944/19 të datës 08 maj 2019.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;  
Të emëruarit  
Anëtarëve të Komisionit  
Arkives*

**Nr.02-020/05-0053551/19  
Podujevë, 03 korrik 2019**





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të neneve 13, 17 shkronja f) dhe 58 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenin 5.2 (i) të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, nr.03/L-087, nenin 23 (Lista 2 – Stacionet e Autobusëve, nr.2) të Ligjit nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, neneve 16, 19 paragrafi 1.6 dhe 61 paragrafi 1.3, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/18, dhe sipas nenit 1 paragrafi 2 të Vendimit nr.01-020/04-0037950/19 për ngritjen e Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Stacioni i Autobusëve Podujevë, të miratuar nga Kuvendi i Komunës së Podujevës, më 08 maj 2019, merr,

### **VENDIM PËR EMËRIMIN E ANËTARIT NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE TË NDËRMARRJES PUBLIKE STACIONI I AUTOBUSËVE PODUJEVË**

#### **Neni 1**

Anëtar i Komisionit Komunal të Aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Stacioni i Autobusëve Podujevë, emërohet,

***z. Gëzim Namani, Drejtor i Drejtorisë së Administratës***

#### **Neni 2**

Detyrat dhe përgjegjësit e Komisionit, përkatësisht anëtarit të emëruar, janë të përcaktuara me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike nr.03/L-087, Ligjin nr.05/L-009 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.03/L-087 për Ndërmarrjet Publike i Ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin nr.04/L-111, dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

#### **Neni 3**

Ky Vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Kuvendit të Komunës, nr. 01-020/04-0037950/19 të datës 08 maj 2019.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet;  
Të emëruarit  
Anëtarëve të Komisionit  
Arkives*

**Nr.02-020/05-0053552/19  
Podujevë, 03 korrik 2019**



**Kryetari i Komunës  
Agim Veliu**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 14.3 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 dhe nenin 21. 1 të Rregullores MF- nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore, nxjerr:

### **VENDIM PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E PASURISË JO FINANCIARE TË KOMUNËS**

#### **Neni 1**

Ngritet Komisioni për vlerësimin e pasurisë jo financiare të Komunës, në përbërje:

- |                    |          |
|--------------------|----------|
| 1. Enver Fazliu    | kryesues |
| 2. Mehmet Kastrati | anëtar   |
| 3. Xhyldane Nimani | anëtare  |
| 4. Valon Beselica  | anëtar   |
| 5. Valmira Rekaliu | anëtare  |

Mandati i komisionit është dy vite.

#### **Neni 2**

Detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionit janë të përcaktuara me Rregulloren MF- nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurisë jo financiare në organizatat buxhetore.

#### **Neni 3**

Për punën e kryer Komisioni i paraqet raport Kryetarit të Komunës, përmes Drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

#### **Neni 4**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

I dërgohet:

Anëtarëve të komisionit  
Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave  
Arkivit

**Nr. 02-020/04-0054656/19**  
**Podujevë, 08 korrik 2019**



**Kryetari i Komunës**  
**Agim Veliu**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040, nenin 18 paragrafi 7 të Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149 dhe nenin 7 paragrafët 4 dhe 5 të Rregullores së Ministrisë së Administratës Publike nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, nxjerr:

### VENDIM

## PËR NGRITJEN E KOMISIONIT PËRZGJEDHËS AD-HOC PËR ZHVILLIMIN E PROCEDURAVE TË REKRUTIMIT SIPAS KONKURSIT TË DATËS 24.06.2019

### Neni 1

Për zhvillimin e procedurave të rekrutimit në Shërbimin Civil të Komunës së Podujevës, për vendin e punës, pozita; **Inspektor i Mbrojtjes së Mjedisit**, (nr. i referencës RN00005079), në kuadër të Drejtorisë së Inspeksionit, sipas konkursit nr.13-111/01-49890/19 të datës 24 qershor 2019, ngritët Komisioni për zgjedhës ad-hoc, në përbërje:

- |                       |  |           |
|-----------------------|--|-----------|
| 1. Florie Besholli,   | <i>udhëheqëse e sektorit për inspektime,</i>         | kryesuese |
| 2. Eset Abdullahu,    | <i>inspektor i mbrojtjes së mjedisit,</i>            | anëtar    |
| 3. Fitim Bunjaku,     | <i>udhëheqës i sektorit për gjendjen civile,</i>     | anëtar    |
| 4. Kadrije Ajvazi,    | <i>udhëheqëse e sektorit për buxhet dhe financa,</i> | anëtare   |
| 5. Halit Vërshevc, i, | <i>udhëheqës i sektorit të shëndetësisë,</i>         | anëtar    |

### Neni 2

Komisioni detyrat dhe përgjegjësitë i ushtron në përputhje me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil në Republikën e Kosovës, Rregullores 02/2010 për Procedurat e rekrutimit në shërbimin civil, dhe aktet tjera përkatëse në fuqi.

### Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*Iu dërgohet:*  
Zyrës së Personelit  
Anëtarëve  
Arkivës

Nr.prot.02-020/04-0055506/19  
Podujevë, 10 korrik 2019



Kryetari i Komunës  
Agim Veliu



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862 të datës 29 qershor 2018, nenet 9.1 dhe 13.2), 3) të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400, sipas rekomandimit të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. 02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, merr:

### **VENDIM**

### **PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PERSONAVE NË GJENDJE TË RËNDË SOCIALE E SHËNDETËSORE**

#### **Neni 1**

Dyzet e pesë (45) personave në gjendje të rëndë sociale-ekonomike dhe shëndetësore u jepet ndihmë financiare, në shumë të përgjithshme 5,650.00 €.

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

#### **Neni 2**

Mjetet financiare ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

#### **Neni 3**

Lista e përfituesve të ndihmës financiare është pjesë përbërëse e Vendimit.

#### **Neni 4**


Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

#### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr.02-400/01-0056330/19**  
**Podujevë, 12 korrik 2019**



  
**Kryetari i Komunës**  
**Agim Veliu**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të nenit 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, në pajtim me Rregulloren MF - Nr - 04/2017 mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe neni 61 parag. 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, pas publikimit të rezultateve përfundimtare nga ana e Komisionit, të përzgjedhjes së OJQ-ve dhe Klubeve sportive për financim publik të programeve/projekteve në fushën e aktiviteteve kulturore, rinore dhe aktiviteteve sportive, sipas Thirrjeve publike të dt. 28.03.2019, merr:

### **VENDIM**

## **PËR MBËSHTETJE FINANCIARE ORGANIZATAT JO-QEVERITARE-OJQ DHE KLUBET SPORTIVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS**

### **Neni 1**

Për financim publik të organizatave jo-qeveritare OJQ-të dhe Klubeve sportive për realizimin e programeve/projekteve në fushën e aktiviteteve kulturore dhe rinore si dhe aktiviteteve sportive, sipas Thirrjeve publike të dt. 28.03.2019, ndahen mjete financiare në shumë të përgjithshme 29,600 €.

### **Neni 2**

Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit për kushtet dhe mënyrën e realizimit të projekteve si dhe për mënyrën e financimit publik, me secilin përfitues të mbështetjes financiare lidhë kontratë me shkrim në përputhje me Rregulloren mbi kriteret standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe procedurën e përcaktuar në Udhëzimin për aplikuesit.

### **Neni 3**

Listat përfundimtare të përfituesve me shumat përkatëse për secilën OJQ / Klub sportiv janë pjesë përbërëse e këtij Vendimi.


### **Neni 4**


Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

**Nr. 02-400/03-0055927/19**  
**Podujevë, dt. 11 korrik 2019**



  
**Kryetari i Komunës**  
**Agim Veliu**





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L – 040, nenin 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-02/01-0050862/18, nenet 8 dhe 15 të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400, Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarjen e mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 dhe Vendimin për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2019 dhe parashikimet buxhetore 2020-2021 nr.01-400/03-0078667/18, dt. 26.09.2018, në rekomandim të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës Nr.02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, sipas Ftesës Publike nr.12-320/01-0021742/19, dt. 12.03.2019, merr:

### **VENDIM PËR NDARJEN E MOTOKULTIVATORËVE ME PAJISJE PËRCJELLËSE NË PERIMKULTURË DHE PEMISHTE FERMERËVE NË KOMUNËN E PODUJEVËS**

#### **Neni 1**

1. Ndahen 100 (njëqind) motokultivator me pajisje përcjellëse për fermerët përfitues nga Komuna e Podujevës, në projektin “Motokultivator me pajisje përcjellëse në perimekulturë dhe pemishte”, në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.
2. Projekti sipas ftesës publike, realizohet përmes formës së participimit dhe atë; Komuna e Podujevës subvencionon 70% të vlerës së projektit, ndërsa fermerët përfitues marrin pjesë me 30% të vlerës së projektit.

#### **Neni 2**

Subvencioni bëhet me qëllim të promovimit dhe zhvillimit të bujqësisë në territorin e Komunës së Podujevës.

#### **Neni 3**

Lista e përfituesve sipas nenit 1 është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

#### **Neni 4**

Zbatimin e Vendimit e bën Drejtoria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në bashkëpunim me Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave të cilat koordinojnë rreth aktiviteteve me fermerët përfitues me qëllim të implementimit të projektit.

#### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr. 02-320/01-0056703/19**  
**Podujevë, 15 korrik 2019**





**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenin 58 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenin 14.2 të Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere, nr.01/111-400 dhe Rregulloren për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr. 01/172-400 dhe Vendimin e Kuvendit të Komunës për miratimin e projektbuxhetit të Komunës së Podujevës për vitin 2019 nr. 01-400/03-0078667/18 (Kodi: 92025), datë 26.09. 2018, sipas konkursit të Drejtorisë së Arsimit nr. 05-45, dt. 12.02.2019, në rekomandim të Komisionit të ngritur me vendimin e Kryetarit të Komunës nr. Nr. 02-020/04-0011787/19, për shqyrtimin e kërkesave për mbështetje dhe ofrim të ndihmave nga kategoria e mjeteve buxhetore subvencione dhe transfere, merr:

### **VENDIM PËR NDARJEN E BURSAVE**

#### **Neni 1**

1. Tetëdhjetë e gjashtë (86) studentëve të Komunës së Podujevës, të cilët vijojnë studimet në fakultet e Universiteteve Publike të Republikës së Kosovës, u ndahet bursë në shumë prej 300 € (shuma e përgjithshme 25,800 €), për vitin akademik 2018-2019.

2. Nëntëdhjetë e katër (94) nxënësve të Shkollave të Mesme të Komunës së Podujevës, u ndahet bursë, në shumë prej 150 € (shuma e përgjithshme 14,100 €), për vitin mësimor 2018-2019.

#### **Neni 2**

Shuma e mjeteve individuale nuk tejkalon shumën e mjeteve financiare sipas Rregullores për caktimin e kritereve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere.

#### **Neni 3**

Pagesa e mjeteve sipas nenit 1 të këtij Vendimi bëhet nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Arsimit.

#### **Neni 4**

Pjesë përbërëse e Vendimit është Lista e përfituesve të bursave.

#### **Neni 5**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Arsimit.

**Nr.02-610/07-0056845/19**  
**Podujevë, 15 korrik 2019**



**Kryetari i Komunës**  
**Agim Veliu**



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



## KRYETARI I KOMUNËS

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L-040, nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr. 01-020/01-0050862/18, në zbatim të dispozitave të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë nr. 03/L-048, merr:

### VENDIM

#### Neni 1

Ngritet Grupi punues për përgatitjen e Librit të Proceseve për menaxhimin dhe kontrollin e financave publike të Komunës, në përbërje:

1. Isuf latifi, kryesues
2. Sabedin Namani, anëtar
3. Kadrie Ajvazi, anëtare
4. Ragip Jaholli, anëtar
5. Rasim Fejza, anëtar
6. Hamide Jashari, anëtare
7. Sabit Syla, anëtar
8. Enver Fazliu, anëtar
9. Rrahim Berisha, anëtar
10. Blerim Nishefci, anëtar
11. Mehmet Kastrati, anëtar
12. Ismet Hyseni, anëtar
13. Ismet Kadriu, anëtar

#### Neni 2

Grupi punues do të përgatitë Librin e Proceseve i cili do të përmbajë përshkrimin e proceseve; menaxhimi i burimeve njerëzore, menaxhimi financiar, menaxhimi i pronës, prokurimi publik dhe të ngjashme, si dhe të dhënat tjera të aktiviteteve në funksion të menaxhimit dhe kontrollit të financave publike të Komunës.

#### Neni 3


Grupi për punën e tij informon Kryetarin e Komunës në formë të shkruar.

#### Neni 4

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

*U dërgohet:  
Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave  
Anëtarëve të Grupit punues*

**Nr. 02-020/07-0058165/19  
Podujevë, 19 korrik 2019**



**Kryetari i Komunës  
Agim Veliu**



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KRYETARI I KOMUNËS**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 shkronja b) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/L – 040, nenin 2 parag. 5 dhe 6 të Rregullores së MF-Nr-04/2017 mbi kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve dhe nenet 16 dhe 61 paragrafi 1.2 të Statutit të Komunës nr.01-020/01-0050862/18, sipas kërkesës nr.09-615/03-0058755/19 të datës 23.07.2019 të proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit (kërkesa me nr. prot.02-400/04-0059057/19 ), merr:

### **VENDIM PËR MBËSHTETJE FINANCIARE OJQ “FRENCH – KOSOVAR ASSOCIATION MITROVICË”**

#### **Neni 1**

OJQ “French –Kosovar Association Mitrovicë”, për realizimin e Ditës së Mërgimtarëve, me aktivitete të përbashkëta mes Komunave Mitrovicë, Vushtrri, Podujevë, që do të mbahet më 28.07.2019 në Shalë të Bajgorës, mbështetet me mjete financiare, në shumë 500.00 €.

#### **Neni 2**

Obligohet Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit që për realizimin e këtij projekti, të lidh kontratë me përfituesin duke respektuar standardet themelore të financimit lidhur me kontraktimin, monitorimin, publikimin dhe raportimin sipas dispozitave të kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 3**

Mjetet buxhetore ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve në kuadër të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit dhe përmes bankës barten në llogarinë e OJQ “French-Kosovar Association Mitrovicë”.

#### **Neni 4**

Zbatimin e vendimit e bën Drejtoria e Buxhetit dhe Financave, dhe Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit.

#### **Neni 5**

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Nr.02-400/04-0059057/19**  
**Podujevë, 23 korrik 2019**



**Kryetari i Komunës**  
**Agim Veliu**